



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 Prill 2017) dhe në bazë të neneve 107, 108, 109 dhe 114 dhe të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), dhe nenin 131, 132 dhe 136 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ADMINISTRIMIN ZYRTAR DHE LIKUIDIMIN E INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE DHE INSTITUCIONEVE TË PARASË ELEKTRONIKE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është t'i përcaktojë dhe rregullojë procedurat e administrimit zyrtar dhe likuidimit të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe legjislacionin për shërbimet e pagesave.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të autorizuar, në pajtim me Ligjin për Shërbimet e Pagesave, për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore e kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të Ligjit Nr.10/L-026 për Shërbimet e Pagesave dhe legjislacionin në fuqi për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare .
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj Rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
 - 2.1. **“BQK”** nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
 - 2.2. **“IPE”** nënkupton institucionin e parasë elektronike;
 - 2.3. **“IP”** nënkupton institucionin e pagesave;
 - 2.4. **“Institucion”** nënkupton IPE-të dhe IP-të;
 - 2.5. **“LSHP ”** nënkupton Ligjin Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave;

- 2.6. **“Organ drejtues”** nënkupton drejtorët ose personat përgjegjës për menaxhimin e IP-ve dhe IPE-ve dhe, kur është relevante, personat përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të shërbimeve të pagesave të IP-ve dhe IPE-ve.

Neni 3

Administrimi zyrtar, likuidimi i detyruar dhe likuidimi vullnetar

1. BQK-ja mund të emërojë një Administrator Zyrtar për një IP ose IPE nëse:
 - 1.1. BQK-ja konstaton se institucioni ka shkelur ndonjë dispozitë të ligjeve ose rregulloreve, ose është angazhuar në ndonjë praktikë të pasigurt dhe jo të shëndoshë, në mënyrë të tillë që të dobësojë gjendjen e institucionit, t’i rrezikojë seriozisht interesat e përdoruesve ose t’i shpërndajë asetet e IP-së ose të IPE-së ose t’i rrezikojë fondet e përdoruesve;
 - 1.2. BQK-ja ka bazë të arsyeshme për të besuar se institucioni ose organi i tij menaxhues janë përfshirë ose janë duke u përfshirë në aktivitete kriminale të dënueshme me burgim prej një viti ose më shumë, në mënyrë të tillë që t’i rrezikojnë interesat e përdoruesve;
 - 1.3. BQK-ja përcakton se IP-ja ose IPE-ja është në gjendje të pasigurt ose jo të shëndoshë për të kryer transaksione dhe institucioni ose organi i tij menaxhues nuk është në gjendje të zbatojë menjëherë përmirësimet ;
 - 1.4. IP-ja ose IPE-ja dështon në çfarëdo mënyre të bashkëpunojë me BQK-në, ose ekzaminerët e saj dhe t’i mundësojë BQK-së t’i përmbushë përgjegjësitë e saj mbikëqyrëse, duke përfshirë fshehjen ose mosdorëzimin për inspektim të ndonjëres nga librat, dokumentet ose shënimet e institucionit;
 - 1.5. institucioni, organi i tij menaxhues, punonjësit ose aksionarët kryesorë nuk e respektojnë urdhrin e BQK-së siç përcaktohet dhe lëshohet me LSHP ose ndonjë ligj tjetër në fuqi;
 - 1.6. institucioni kërkon emërimin e një Administratori Zyrtar;
 - 1.7. niveli i kapitalit rregullativ të IP-së ose IPE-së bie nën pesëdhjetë përqind (50%) të kapitalit rregullativ minimal të kërkuar sipas dispozitave të LSHP-së dhe rregulloreve të BQK-së për kapitalin dhe fondet vetanake; ose
 - 1.8. BQK-ja konsideron se një institucion tjetër financiar ose ndonjë aksionar tjetër që ka interes të konsiderueshëm në IP ose IPE përballat me rrezikun që të bëhet josolvent ose nuk i përmbushë kërkesat rregullative në lidhje me kapitalin ose likuiditetin nga BQK-ja ose në juridiksionin e selisë të korporatës së saj.
2. Nëse BQK-ja përcakton se IP-ja ose IPE-ja nuk mund të rehabilitohen përmes administrimit zyrtar ose nëse BQK-ja vendos të tërheqë autorizimin e IP-së ose IPE-së, BQK-ja nxjerrë një vendim për revokimin e autorizimit të IP-së ose IPE-së siç përcaktohet në përputhje me LSHP-në dhe vazhdon me procedura të likuidimit të detyruar nëpërmjet likuiduesit të emëruar.
3. Në rast se IP-ja ose IPE-ja, me vendim të aksionarëve të tij/saj, kërkon që të revokohet autorizimi sipas dispozitave të LSHP-së dhe kur BQK-ja, përveç planit që i paraqitet asaj, përcakton se IP-ja ose IPE-ja ka pasuri të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të saj, likuidimi vullnetar kryhet menjëherë dhe të gjithë përdoruesit marrin fondet e tyre brenda pesë ditëve nga IP-ja ose IPE-ja. Pavarësisht nga ajo që u cek më lart, nëse BQK-ja përcakton, edhe gjatë rrjedhës së likuidimit të tillë, se IP-ja ose IPE-ja nuk siguron likuidim të rregullt ose nuk respekton LSHP-në

ose ndonjë udhëzim të nxjerrë nga BQK-ja, atëherë zbatohen dispozitat e likuidimit të detyruar për emërimin e likuiduesve.

Neni 4

Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit Zyrtar

1. BQK-ja mund të emërojë një Administrator Zyrtar për institucionin e pagesave ose institucionin e parasë elektronike siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Rregullore, nenin 109 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe nenin 132 të LSHP-së.
2. Në vendimin e BQK-së për emërimin e Administratorit Zyrtar specifikohet baza mbi të cilën është miratuar. Për vendimin e tillë njoftohet menjëherë IP-ja ose IPE-ja që i nënshtrohet administrimit zyrtar.
3. BQK-ja ka kompetencën ekskluzive për ta larguar këtë Administrator Zyrtar në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-093 për banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.
4. Administratori Zyrtar emërohet nga BQK-ja për një mandat, jo më shumë se gjashtë (6) muaj, siç specifikohet në vendimin e BQK-së. Afati i emërimit mund të zgjatet nga BQK-ja vetëm dy herë, për një periudhë jo më të gjatë, në secilin rast, se tre (3) muaj. Nëse Administratori Zyrtar nuk i ka zgjidhur çështjet për të cilat është emëruar t'i zgjidhë pas një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore, autorizimi revokohet dhe fillon procesi i likuidimit të IP-së ose IPE-së.
5. Nëse rrethanat për të cilat emërimi i administratorit zyrtar nuk zgjidhen pas një periudhe prej dymbëdhjetë (12) muajsh, autorizimi i IP-së ose IPE-së revokohet dhe fillon procesi i likuidimit.
6. Pavarësisht nga paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, BQK-ja mund të konstatojë se institucioni është ose është bërë solvent. Në atë rast, afatet për emërimin e Administratorit Zyrtar të përfshira në këtë nen mund të vazhdojnë me urdhër të shkruar të BQK-së në mënyrë që të sigurohet koha e duhur për shitjen e rregullt ose disponimin ndryshe me atë institucion.
7. Administratori Zyrtar mund të jetë një person nga sektori privat ose një zyrtar i BQK-së i cili i plotëson kualifikimet e përcaktuara nga BQK-ja në Rregulloren përkatëse.
8. Vendimi i BQK-së për emërimin e një Administratori Zyrtar për IP-në ose IPE-në hyn në fuqi në kohën e specifikuar në vendim ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur është dhënë njoftimi sipas paragrafit 2 të këtij neni.
9. Pas emërimit, të gjitha kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e organit drejtues të IP-së ose IPE-së dhe aksionarëve i ngarkohen Administratorit Zyrtar, përveç rasteve kur Administratori Zyrtar kërkon nga organi drejtues ose aksionarët të kryejnë ndonjë aktivitet të parashikuar në LSHP ose këtë Rregullore. Çdo veprim ose vendim i marrë nga ose në emër të IP-së ose IPE-së që i nënshtrohet administrimit zyrtar është i pavlefshëm, përveç nëse merret nga ose nën autoritetin e Administratorit Zyrtar.
10. BQK-ja mund ta shkarkojë Administratorin Zyrtar para përfundimit të mandatit të specifikuar në paragrafin 4 më lart dhe të emërojë një zëvendësues të kualifikuar. BQK-ja duhet të sigurojë që IP-ja ose IPE-ja janë në çdo kohë nën kontrollin e Administratorit Zyrtar të emëruar në mënyrë të rregullt.

11. Çdo transaksion që përfshin IP-në ose IPE-në nën administrim zyrtar në të cilin Administratori Zyrtar ka interes apo lidhje materiale në këtë çështje mund të angazhohet vetëm me miratimin paraprak të BQK-së. Nëse Administratori Zyrtar nuk shpalos interesin apo lidhjen materiale siç kërkohet, kontrata mund të anulohet dhe BQK-ja e shkarkon Administratorin Zyrtar.

Neni 5

Kompetencat dhe detyrat e Administratorit Zyrtar

1. Administratori Zyrtar ka kompetenca të plota dhe ekskluzive për të menaxhuar dhe operuar institucionin. Administratori Zyrtar mund të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm ose të përshtatshëm për të vazhduar ushtrimin e aktivitetit të IP-së ose IPE-së dhe për të ruajtur dhe mbrojtur fondet e përdoruesve, aktivet dhe pronën e institucionit ose për të zbatuar planin e veprimeve në lidhje me IP-në ose IPE-në që është miratuar nga BQK-ja.
2. Administratori Zyrtar vepron në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe udhëzuesit e dhënë nga BQK-ja në çdo kohë gjatë administrimit zyrtar dhe i përgjigjet vetëm BQK-së për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave si Administrator Zyrtar. Administratori Zyrtar mund t'ua delegojë ndonjë nga këto kompetenca apo detyra personave të tjerë, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga BQK-ja.
3. Administratori Zyrtar pezullon pagesën e çdo dividendi ose formë tjetër të shpërndarjes së kapitalit për aksionarët, si dhe çdo pagesë për menaxhmentin, përveç për shërbimet e ofruara për IP-në ose IPE-në me kërkesë të Administratorit Zyrtar.
4. Administratori Zyrtar mund të punësojë, me shpenzime të IP-së ose IPE-së nën administrim zyrtar, avokatë, kontabilistë dhe konsulentë të pavarur për ta ndihmuar Administratorin Zyrtar, sipas kushteve të miratuara nga BQK-ja.
5. Nëse Administratori Zyrtar ka bazë të arsyeshme për të besuar se aksionarët, drejtorët, zyrtarët, avokatët, kontabilistët ose profesionistët e tjerë janë përfshirë ose janë duke u përfshirë në aktivitete kriminale të dënueshme me burgim prej një viti ose më shumë ose me aktivitete mashtruese, ai e njofton menjëherë BQK-në dhe parashtron padi civile në kërkim të dëmeve dhe kompensimit.

Neni 6

Moratoriumi dhe Efekti i Administrimit Zyrtar në Procedurat dhe Kontratat

1. BQK-ja, pas kërkesës me shkrim nga Administratori Zyrtar, mund të vendosë një moratorium duke pezulluar disa ose të gjitha pagesat nga një IP ose IPE nën administrim zyrtar.
2. Nëse vendoset nën moratorium, atëherë pa pëlqimin e BQK-së:
 - 2.1. një person nuk mund të fillojë ose të vazhdojë një procedurë në gjykatë kundër një IP-je ose IPE-je nën administrim zyrtar, dhe
 - 2.2. një person nuk mund të ushtrojë të drejta sipas hipotekës, ngarkesës ose sigurisë tjetër ndaj pronës së një IP-je ose IPE-je nën administrim zyrtar, apo të lëshojë ndonjë ekzekutim, të bashkëngjisë ndonjë borxh, ose të zbatojë ose të përpiqet të zbatojë ndonjë vendim ose urdhër të marrë në lidhje me një IP-në ose IPE-në nën administrim zyrtar.
3. BQK-ja me pëlqim me shkrim mund të heqë dorë nga zbatimi i paragrafëve 2.1 dhe 2.2 të këtij

neni për çdo kreditor apo klasë të kreditorëve.

4. Asnjë e drejtë ose detyrim sipas ndonjë kontrate në të cilën IP-ja ose IPE-ja nën administrim zyrtar është palë nuk mund të ndërpritet, përshpejtohet ose modifikohet vetëm për shkak të emërimit të Administratorit Zyrtar ose ndonjë veprimi të ndërmarrë nga Administratori Zyrtar.

Neni 7

Marrja e kontrollit

1. Menjëherë pas emërimit, Administratori Zyrtar siguron pronat, zyrat, pasuritë, librat dhe shënimet e IP-së ose IPE-së, dhe mund t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm ose të duhur që synojnë këtë qëllim, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
 - 1.1. kufizimin e qasjes së jashtme ose qasjes së brendshme në objektet e institucionit;
 - 1.2. ndërrimin e fjalëkalimeve në kompjuterët e IP-së ose IPE-së dhe mundësimin e qasjes vetëm për një numër të kufizuar punonjësish;
 - 1.3. lëshimin e kartelave të reja të hyrjes për punonjësit e autorizuar në ambientet e institucionit dhe kontrollin e qasjes së punonjësve të tjerë në ato ambiente.
2. Gjatë administrimit zyrtar, Administratori Zyrtar ka qasje dhe kontroll të pakufizuar mbi pronat, zyrat, pasuritë dhe librat kontabël dhe të dhënat e tjera të institucionit që i nënshtrohet administrimit zyrtar.
3. Menjëherë pas kërkesës së Administratorit Zyrtar, zyrtarët e zbatimit të ligjit, nëse është e nevojshme me përdorimin e forcës, e ndihmojnë Administratorin Zyrtar që të ketë qasje në çdo objekt të IP-së ose IPE-së dhe të fitojë kontrollin dhe t'i sigurojë pronat, zyrat, pasuritë, librat dhe shënimet e tilla. Vendimi i BQK-së për emërimin e Administratorit Zyrtar ka fuqi juridike dhe efektin e një urdhri të detyrueshëm administrativ .
4. Drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e IP-së ose IPE-së vënë në dispozicion të Administratorit Zyrtar të gjitha shënimet dhe dokumentacionin që i përket institucionit dhe çdo informacion apo raport shtesë të kërkuar nga Administratori Zyrtar.

Neni 8

Regjistrimi dhe plani i veprimit

1. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas emërimit, Administratori Zyrtar përgatitë dhe dorëzon në BQK listën e regjistrimit të pasurive dhe detyrimeve të IP-së ose IPE-së. Ky raport jep në detaje pasuritë sipas profileve të ndryshme të rrezikut dhe klasifikon kreditë joperformuese.
2. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas emërimit, Administratori Zyrtar përgatitë dhe dorëzon në BQK raportin e gjendjes financiare dhe prospektet e ardhshme të IP-së ose IPE-së që i nënshtrohen administrimit zyrtar.
3. Në raportin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, Administratori Zyrtar propozon një plan veprimi dhe rekomandon:
 - 3.1. rikuperimin e IP-së ose IPE-së duke zbatuar një plan veprimi korrigjues që mund të përfshijë rritjen e kapitalit; ose

- 3.2. likuidimin e IP-së ose IPE-së, nëse IP-ja ose IPE-ja nuk mund të rikuperohen.
4. Administratori Zyrtar siguron menjëherë çdo raport apo informacion shtesë të kërkuar nga BQK-ja.

Neni 9

Rritja e kapitalit nga aksionarët ekzistues

1. Në bazë të raportit të përgatitur sipas nenit 8 të kësaj Rregulloreje dhe me miratimin e BQK-së, Administratori Zyrtar mund t'i ndërmarrë veprimet e mëposhtme për të rritur kapitalin e institucionit përmes emetimit të aksioneve të reja pasi:
 - 1.1. të përcaktojë masën e humbjeve dhe të përgatisë bilancin e gjendjes së IP-së ose IPE-së që mbulon shumën e humbjeve të tilla përmes fitimeve, rezervave dhe, nëse është e nevojshme, kapitalit të IP-së ose IPE-së; dhe
 - 1.2. t'i njoftojë aksionarët ekzistues për shumën e kapitalit shtesë të nevojshëm për të sjellë kapitalin e IP-së ose të IPE-së në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e kapitalit dhe t'i lejojë këta aksionarë të regjistrojnë dhe blejnë aksione shtesë, duke paraqitur zotimet detyruese të barabarta me shumën e plotë të kapitalit shtesë të nevojshëm brenda tri ditë pune pas atij njoftimi.
2. Aksionarët ekzistues të IP-së ose IPE-së nën Administrim Zyrtar nuk kanë të drejtë përparësie ose të tjera për të blerë aksione shtesë të emetuara, përveç siç parashikohet në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe këtij neni.

Neni 10

Rikapitalizimi nga aksionarët e rinj

1. Në bazë të raportit të përgatitur sipas nenit 8 të kësaj Rregulloreje dhe pas miratimit të BQK-së, Administratori Zyrtar mund t'i ndërmarrë veprimet e mëposhtme për të rritur kapitalin e IP-së ose IPE-së përmes emetimit të aksioneve për aksionarët e rinj në rrethanat e mëposhtme:
 - 1.1. në rast se zotimet detyruese nuk dorëzohen në shumën e barabartë me shumën e plotë të kapitalit shtesë që u nevojitet aksionarëve ekzistues; ose
 - 1.2. nuk iu ofron aksione aksionarëve ekzistues, nëse BQK-ja përcakton se:
 - 1.2.1. aksionarët ekzistues nuk janë më të përshtatshëm për të mbajtur një pozicion të konsiderueshëm të kapitalit në institucion; ose
 - 1.2.2. nuk është arritur të veprohet në kohë në pajtim me masën përmirësuese sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje që kërkon rritje të kapitalit të IP-së ose të IPE-së.
2. Për të bërë rikapitalizimin nga aksionarët e rinj, Administratori Zyrtar:
 - 2.1. nëse nuk është bërë tashmë në përputhje me nenin 9 të kësaj Rregulloreje, përcakton masën e humbjeve dhe përgatitë bilancin e gjendjes së IP-së ose IPE-së që mbulon shumën e humbjeve të tilla përmes fitimeve, rezervave dhe, nëse është e nevojshme, kapitalit të IP-së ose IPE-së;
 - 2.2. nëse është e nevojshme, i pasqyron humbjet, e zvogëlon vlerën nominale të aksioneve në

qarkullim, pavarësisht çdo dispozite tjetër të legjislacionit në fuqi;

- 2.3. përcakton shumën dhe llojin e financimit të nevojshëm që IP-ja ose IPE-ja t'i përmbushë të gjitha kërkesat e kapitalit;
 - 2.4. bën që IP-ja ose IPE-ja të emetojë aksione shtesë në shumën e nevojshme dhe të kryejë shitjen e aksioneve nga IP-ja ose IPE-ja dhe blerjen e aksioneve të tilla nga investitorët e rinj.
3. Pavarësisht nga ndonjë ligj që mund të hyjë në fuqi për të rregulluar tregun e letrave me vlerë dhe shpalosje të tjera nga emetuesit e letrave me vlerë, autoriteti kompetent sipas atij ligji i ndërmerr veprimet e nevojshme për të lejuar çdo emetim të tillë sipas këtij neni brenda tri (3) ditëve të punës.

Neni 11

Bashkimi, shitjet dhe ristrukturimet e tjera

1. Në bazë të raportit të përgatitur sipas nenit 8 të kësaj Rregulloreje dhe pas miratimit nga BQK-ja, Administratori Zyrtar mund të bëjë bashkimin e IP-së ose IPE-së ose një transferim, tërësisht ose pjesërisht, të pasurive dhe detyrimeve të IP-së ose të IPE-së.
2. Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga BQK-ja, Administratori Zyrtar mund të miratojë një ristrukturim të detyrimeve të IP-së ose IPE-së përmes marrëveshjeve me kreditorët e IP-së ose IPE-së, duke përfshirë reduktimin, modifikimin, riprogramimin dhe rinovimin e kërkesave të tyre.

Neni 12

Shpenzimet e Administratorit Zyrtar

Administratori Zyrtar pranon kompensimin e përcaktuar nga BQK-ja. Të gjitha kostot dhe shpenzimet e bëra për administrimin zyrtar barten dhe i ngarkohen institucionit që i nënshtrohet kësaj procedure.

Neni 13

Përfundimi i Administrimit Zyrtar

1. Administrimi zyrtar përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar në vendimin për emërimin e Administratorit Zyrtar ose çdo zgjatje të mandatit të këtij emërimi siç parashikohet në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.
2. Administrimi zyrtar ndërpritet para skadimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse BQK-ja përcakton se:
 - 2.1. administrimi zyrtar nuk është më i nevojshëm për shkak se shkaqet për emërimin e Administratorit Zyrtar janë rregulluar; ose
 - 2.2. IP-ja ose IPE-ja nuk mund të rehabilitohen dhe BQK-ja nxjerr një vendim për revokimin e autorizimit përkatës sipas nenit 16 të LSHP-së dhe për fillimin e procedurës së likuidimit sipas dispozitave të nenit 132 të LSHP-së ose sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
3. Në rast të ndërprerjes së administrimit zyrtar që nuk përfshin mbylljen e IP-së ose IPE-së, Administratori Zyrtar kryen detyrat e organit drejtues të IP-së ose IPE-së deri në emërimin dhe/ose zgjedhjen e anëtarëve të rinj të organit drejtues. Pas emërimit dhe/ose zgjedhjes së anëtarëve të rinj të organit drejtues, Administratori Zyrtar ua kthen kontrollin e pronave, zyrave, pasurive,

librave dhe regjistrave të IP-së ose IPE-së organeve kompetente.

4. Vendimi i BQK-së për ndërprerjen e administrimit zyrtar shoqërohet me rekomandimin e Administratorit Zyrtar dhe një raport të detajuar të përgatitur nga Administratori Zyrtar që mbështet rekomandimin.
5. Brenda pesë (5) ditëve nga ndërprerja e emërimit, Administratori Zyrtar përgatitë dhe dorëzon në BQK një raport përfundimtar dhe kontabilitetin e administrimit zyrtar.

Neni 14 **Llojet e likuidimit**

1. IP-ja ose IPE-ja likuidohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe këtë Rregullore, në dy mënyra:
 - 1.1. likuidim vullnetar;
 - 1.2. likuidim i detyruar.

Neni 15 **Likuidimi vullnetar**

1. Asnjë IP apo IPE nuk mund të ndërpresë vullnetarisht aktivitetet e saj pa marrë fillimisht miratimin paraprak nga BQK-ja në përputhje me këtë nen.
2. Likuidimi vullnetar hyn në fuqi kur:
 - 2.1. aksionarët e IP-së ose IPE-së vendosin të dërgojnë IP-në ose IPE-në në proces likuidimi;
 - 2.2. aksionarët e IP-së ose IPE-së vendosin ndërrimin e veprimtarisë së IP-së ose IPE-së ose ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarisë së tyre.
3. Në raste të tilla siç parashikohet në paragrafin 2 të këtij neni, IP-ja ose IPE-ja:
 - 3.1. e njofton paraprakisht BQK-në për vendimin e tillë;
 - 3.2. Së bashku me vendimin, IP-ja ose IPE-ja e dorëzon në BQK:
 - 3.2.1. kërkesën për pëlqim të aksionarëve të IP-së ose të IPE-së për përfundimin e veprimtarisë të IP-së ose IPE-së,
 - 3.2.2. garancinë bankare të pakushtëzuar dhe të parevokueshme të pagueshme me kërkesë të parë, të lëshuar nga një bankë me një vlerësim të klasës investuese. Kjo garanci duhet t'i mbulojë të gjitha obligimet e IP-së ose IPE-së dhe të jetë në favor të BQK-së. BQK-ja gjithashtu mund të kërkojë nga banka dokumentacion tjetër të nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.
4. BQK-ja vendosë për kërkesën e referuar në paragrafin 3 të këtij neni duke marrë vendim brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i kërkesës të plotësuar siç duhet.
 - 4.1. BQK-ja ia dërgon vendimin institucionit jo më vonë se dita e ardhshme e punës pas ditës së dhënies së tij;

- 4.2. nëse BQK-ja nuk jep pëlqimin për likuidim vullnetar për shkak të dështimit të IP-së ose IPE-së për të dorëzuar dokumentacionin në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ose nuk respekton këtë Rregullore ose ndonjë udhëzim të nxjerrë nga BQK-ja, atëherë zbatohen dispozitat e nenit 16 dhe 132 të LSHP-së për emërimin e likuidatorit dhe BQK-ja njëkohësisht revokon autorizimin e IP-së ose të IPE-së;
- 4.3. BQK-ja mund ta japë pëlqimin për likuidim vullnetar nëse konstaton se IP-ja ose IPE-ja ka pasuri të mjaftueshme për t'i përmbushur detyrimet e saj, në këtë rast likuidimi kryhet menjëherë dhe të gjithë përdoruesit (klientët) rimbursohen nga fondet e tyre brenda pesë (5) ditëve nga IP-ja ose IPE-ja, në përputhje me procedurat që do t'i nxjerrë BQK-ja dhe nën mbikëqyrjen e kësaj të fundit.
5. Vendimi për likuidim vullnetar shpallet dhe publikohet nga IP-ja ose IPE-ja në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në dy gazeta kombëtare.
6. Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare zbatohen për likuidimin vullnetar deri në masën që nuk janë në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 16

Bazat për fillimin e likuidimit të detyruar

1. Në rast të tërheqjes së autorizimit të një IP-je ose IPE-je në përputhje me nenet 16 dhe 132 të LSHP-së, përveç revokimit sipas paragrafit 4.2 të nenit 15 të kësaj Rregulloreje, BQK-ja merr njëkohësisht dhe kontrollin e asaj IP-je ose IPE-je përmes një likuiduesi të emëruar nga BQK-ja. Ky proces njihet si likuidim i detyruar.
2. Likuidatori mund të jetë person nga sektori privat ose zyrtar i BQK-së i cili i plotëson kualifikimet e përcaktuara nga BQK-ja. BQK-ja mund ta shkarkojë likuidatorin. Kushtet e kompensimit të likuidatorit përcaktohen nga BQK-ja dhe mund të përfshijnë stimuj për përmbushjen e objektivave të përcaktuara nga BQK-ja dhe mund të përfshijnë gjoba për mos përmbushjen e objektivave të tilla.
3. Kompensimi i likuiduarit dhe ekspertëve që ai ose ajo angazhon, rimbursimi i shpenzimeve të tyre dhe shpenzimeve të BQK-së në zbatim të kësaj Rregulloreje në lidhje me IP-në ose IPE-në paguhet nga pasuritë e IP-së ose IPE-së. Pagesat për likuidatorin bëhen në baza rrjedhëse nëse sipas gjykimit të likuidatorit ka mjete të mjaftueshme likuide. Të gjitha paratë që i detyrohen likuiduesit në fund të afatit të likuidimit paguhet nga të ardhurat nga shitja e pasurive të IP-së ose IPE-së sipas përparësisë të përshkruar në nenin 20 të kësaj Rregulloreje.

Neni 17

Njoftimi dhe Regjistrimi i Likuidimit

1. Vendimi i BQK-së për emërimin e likuidatorit për një IP ose IPE hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së tij, përveç nëse në vendim përcaktohet ndryshe. Likuidatori, menjëherë pas marrjes së detyrës, vendos një njoftim në secilin objekt të IP-së ose IPE-së, përmes të cilit njofton për tërheqjen e autorizimit dhe për emërimin e tij/saj nga BQK-ja. Njoftimi duhet të përcaktojë datën e hyrjes në fuqi të vendimit, kohën e marrjes në posedim nga likuidatori, si dhe të specifikojë se:
 - 1.1. autorizimet e personave që mbajnë përgjegjësi financiare të IP-së ose IPE-së janë revokuar;

- 1.2. personat të cilët më parë kanë pasur autorizim për të dhënë udhëzime në emër të IP-së ose IPE-së, në lidhje me pagesën ose transferimin e pasurive të IP-së ose IPE-së ose pasurive të mbajtura nga IP-ja ose IPE-ja, nuk janë më të autorizuar; dhe
 - 1.3. autorizimi i IP-së ose IPE-së është tërhequr.
2. Likuidatori publikon një njoftim që specifikon veprimet e ndërmarra në një ose më shumë gazeta me tirazh të përgjithshëm në komunitetet në të cilat IP-ja ose IPE-ja ka lokalet dhe organizon publikimin e njoftimit të tillë çdo javë për katër (4) javët e ardhshme dhe informon sipas nevojës autoritetet kompetente dhe ia dërgojnë BQK-së kopjet e veprimeve të tilla brenda dy (2) ditëve nga veprimi i tillë.

Neni 18

Kompetencat dhe Detyrat e Likuidatorit dhe Efektet e Likuidimit

1. Me emërimin e tij, likuidatori bëhet përfaqësuesi i vetëm ligjor i institucionit dhe trashëgon të gjitha të drejtat dhe kompetencat e aksionarëve dhe të organit drejtues të IP-së ose IPE-së. Të drejta dhe kompetenca të tilla përfshijnë mbajtjen e titullarit të librave, shënimeve dhe pasurive të IP-së ose IPE-së, menaxhimin, funksionimin dhe përfaqësimin e IP-së ose IPE-së, renditjen e pasurive dhe kërkesave, transferimin ose shpërndarjen e pasurisë, dhe marrjen e çdo veprimi tjetër të nevojshëm për likuidimin efikas të IP-së ose IPE-së dhe për të marrë shumën maksimale nga shitja e pasurive, duke përfshirë pa kufizim:
 - 1.1. vazhdimin ose ndërprerjen e çdo operacioni të IP-së ose IPE-së;
 - 1.2. huazimin e parave të garantuara me pasuritë e saj ose pa garanci;
 - 1.3. pezullimin ose kufizimin e pagesës së borxheve që i nënshtrohen miratimit të BQK-së siç parashihet më poshtë;
 - 1.4. punësimin e specialistëve, ekspertëve ose konsulentëve profesionistë;
 - 1.5. administrimin e llogarive të IP-së ose të IPE-së;
 - 1.6. arkëtimin e borxheve për IP-në ose IPE-në dhe rikuperimin e mallrave nga palët e treta;
 - 1.7. iniciimin ose mbrojtjen e IP-së ose IPE-së në çdo procedurë ligjore dhe zbatimin e çdo instrumenti relevant në emër të IP-së ose IPE-së; dhe
 - 1.8. ristrukturimin e detyrimeve të IP-së ose të IPE-së përmes marrëveshjeve me kreditorët e IP-së ose IPE-së, duke përfshirë zvogëlimin, modifikimin, riprogramimin dhe rinovimin e kërkesave të tyre, deri në shumën e përcaktuar nga BQK-ja.
2. Likuidatori vepron në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e dhëna nga BQK-ja në çdo kohë gjatë likuidimit dhe i përgjigjet vetëm BQK-së për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e kompetencave si likuidator.
3. Likuidatori mund të vazhdojë çdo operacion dhe mund të marrë hua para me sigurim ose pa sigurim. Likuidatori mund të ndërpresë ose të kufizojë pagesën për çdo detyrim, të punësojë ose shkarkojë cilindo zyrtar, punonjës ose këshilltar, të përdorë çdo instrument në emër të IP-së ose IPE-së dhe të fillojë ose të mbrojë dhe kryejë në emër të IP-së ose IPE-së çdo veprim ose procedurë ligjore.

4. Likuidatori ka qasje të pakufizuar dhe kontroll mbi zyrat, librat e llogarive dhe shënimet e tjera, si dhe pasuritë e tjera të IP-së ose IPE-së dhe filialeve të tij. Me kërkesë të likuidatorit, zyrtari ose zyrtarët e zbatimit të ligjit ndihmojnë likuidatori që të ketë qasje në objektet e IP-së ose IPE-së ose kontrollin mbi të dhënat e IP-së ose IPE-së.
5. BQK-ja aprovon ose refuzon bashkimin e IP-së ose IPE-së me një institucion tjetër financiar, ose shitjen substanciale të të gjitha pasurive të IP-së ose IPE-së.
6. Likuidatori ka të njëjtat të drejta dhe privilegje dhe i nënshtrohet të njëjtave detyra, dënime, kushte dhe kufizime që zbatohen për organin drejtues ose punonjësit e tjerë të IP-së ose IPE-së të autorizuar sipas LSHP-së.
7. Kompetencat e organit drejtues dhe aksionarëve të IP-së ose IPE-së ndërpriten gjatë likuidimit; megjithatë, me kusht që organi drejtues mund të udhëzohet nga likuidatori për të ushtruar funksione të caktuara për IP-në ose IPE-në, dhe më tej parashikohet se persona të tillë i nënshtrohen shkarkimit nga likuidatori nga pozitat e tyre në IP ose IPE dhe më pas pushojnë të marrin kompensim nga IP-ja ose IPE-ja.
8. Likuidatori siguron pronën, zyrat, librat, shënimet dhe pasuritë e IP-së ose IPE-së për të parandaluar humbjen e tyre nga vjedhja ose veprime të tjera të ndaluara, duke ndërmarrë, duke përfshirë por pa u kufizuar në, veprimet e mëposhtme:
 - 8.1. ndryshimin e bravave dhe kufizimin e mundësisë së marrjes së çelësave të rinj në hyrjet e jashtme në ambientet e IP-së ose IPE-së dhe në dyert e zyrave të brendshme që përmbajnë pasuri financiare ose informacione ose pajisje që mund t'i mundësojnë një personi të fitojë qasje të paligjshme në pasuritë financiare;
 - 8.2. ndërrimin ose vendosjen e kodeve të hyrjes në kompjuterët e IP-së ose IPE-së dhe dhënien e mundësisë së hyrjes për vetëm një numër të kufizuar punonjësish të besueshëm;
 - 8.3. lëshimin e kartelave të reja identifikuese me foto për hyrjen e punonjësve të autorizuar në ambientet e IP-së ose të IPE-së dhe kontrollin e hyrjes së të tjerëve në ambientet e IP-së ose të IPE-së;
 - 8.4. anulimin e autorizimeve të personave për mbajtjen e përgjegjësisë financiare të IP-së ose IPE-së dhe lëshimin e autorizimeve të reja, sipas rastit dhe njoftimin e palëve të treta;
 - 8.5. informimin e të gjitha palëve korresponduese se personat të cilët më parë kanë pasur autorizim për të dhënë udhëzime në emër të IP-së ose IPE-së në lidhje me trajtimin e pasurive të IP-së ose IPE-së nuk janë më të autorizuar dhe se vetëm likuidatori dhe personat e autorizuar nga likuidatori e kanë këtë autoritet; dhe
 - 8.6. pezullimin e pagesës së shpërndarjes së kapitalit në përgjithësi dhe çdo lloj pagese ndaj organit drejtues dhe aksionarëve kryesorë, megjithatë, me kusht që kompensimi i arsyeshëm t'i paguhet organit menaxhues dhe personelit tjetër të IP-së ose IPE-së për shërbimet e kryera ndaj IP-së ose IPE-së me kërkesë të likuidatorit.
9. Likuidatori përgatit bilancin e ri të gjendjes për institucionin, bazuar në përcaktimin e tij/saj të vlerave të likuidimit të aseteve të IP-së ose IPE-së, me zvogëlimin përkatës të vlerës së detyrimeve të IP-së ose IPE-së në rend të kundërt të prioritetit të pagesës së shpërndarjeve në likuidimin e aseteve të IP-së ose IPE-së. Detyrimet konsiderohen të arritura dhe të pagueshme, ndërsa interesi pushon së kalkuluari nga data e emërimit të likuiduesit. Detyrimet e pa maturuara zbriten në vlerën aktuale me normën e interesit të përcaktuar nga BQK.

10. Brenda një (1) muaji nga marrja në posedim të IP-së ose IPE-së, likuidatori bën inventarin e pasurive dhe pronës së IP-së ose IPE-së dhe një kopje të tij ia dërgon BQK-së, e cila do ta vë në dispozicion një kopje për shqyrtim publik.
11. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e emërimit, likuidatori mund të ndërpresë çdo kontratë të parealizuar ose pjesërisht të realizuar, në masën që realizimi i një kontrate të tillë përcaktohet të jetë i rëndë për IP-në ose IPE-në dhe ndërprerja do të promovonte administrimin e rregullt të punëve të IP-së ose IPE-së dhe mbron interesat e përdoruesve. Çdo përgjegjësi që lind nga ndërprerja përcaktohet në datën e ndërprerjes dhe kufizohet në dëmet e drejtpërdrejta të shkaktuara dhe nuk përfshinë asnjë dëm për fitime të humbura ose mundësi ose dëme jomonetare. Në rast të ndërprerjes së kontratës së qirasë së pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme, pronarit i jepet një njoftim prej tridhjetë (30) ditësh.
12. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas datës së emërimit, por jo më vonë se 30 ditë, likuidatori vë në dispozicion për tërheqje nga përdoruesit të gjitha fondet e tyre dhe jep udhëzime të qarta për procesin e tërheqjes.
13. Kur një likuidator e merr në posedim një IP ose IPE:
 - 13.1. pezullohet çdo afat statutor, kontraktues ose tjetër, me skadimin e të cilit skadon ose pushon një kërkesë ose e drejtë e IP-së ose IPE-së;
 - 13.1.1. llogaritja e interesave dhe dënimeve kundrejt detyrimeve të IP-së ose IPE-së pezullohet dhe nuk shtohet ndonjë ngarkesë ose detyrim tjetër mbi detyrimet e IP-së ose IPE-së;
 - 13.1.2. të gjitha procedurat ligjore kundër IP-së ose IPE-së shtyhen dhe pezullohet ushtrimi i çdo të drejte mbi pasuritë e IP-së ose IPE-së. Asnjë e drejtë nuk mund të ushtrohet mbi pasuritë gjatë likuidimit të IP-së ose IPE-së, përveç të drejtave që i janë dhënë likuidatori. Asnjë kreditor nuk mund të vendosë barrë, të shesë apo të marrë në posedim pasuritë e IP-së ose IPE-së për qëllime të ekzekutimit të kërkesës së tij, apo të iniciojë ose vazhdojë ndonjë procedurë ligjore për rikuperimin e borxhit ose për përsosjen e interesave të sigurisë mbi pasuritë e IP-së ose IPE-së
 - 13.2. çdo sekuestrim apo interes siguries, përveç atyre që kanë ekzistuar gjashtë (6) muaj para datës efektive të likuidimit, anulohet. Gjatë kohëzgjatjes së likuidimit, asnjë barrë apo interes siguries, përveç atyre të krijuara nga likuidatori gjatë likuidimit, nuk mund të vendoset mbi pasuritë ose pronën e IP-së ose IPE-së ;
 - 13.3. të drejtat e aksionarëve shuhet, përveç të drejtës së marrjes së të ardhurat (mjetet) eventuale, nëse ka, sipas nenit 19 të kësaj Rregulloreje; dhe
 - 13.4. likuidatori mund t'i shesë pasuritë e IP-së ose IPE-së ose të organizojë marrjen përsipër të detyrimeve të IP-së ose IPE-së në kushte që ai ose ajo i konsideron të drejta.
14. Nëse likuidatori ka bazë të arsyeshme për të besuar se aksionarët, drejtorët, zyrtarët, avokatët, kontabilistët ose profesionistët të tjerë janë përfshirë ose janë duke u përfshirë në veprimtari kriminale ose mashtruese, ai ose ajo parashtron mjetet juridike të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi përfshirë padi civile për të kërkuar dëmshpërblim dhe kthim.

15. Procedura për përcaktimin e vlefshmërisë së pretendimeve, përveç mjeteve të shfrytëzuesve, për likuidimin e pasurive të IP-së apo IPE-së përcaktohet nga BQK-ja, megjithatë, me kusht që shitja e pasurive të IP-së ose IPE-së të kryhet në mënyrë transparente dhe komercialisht të arsyeshme.
16. Çdo pasuri e IP-së ose IPE-së që nuk është shitur në fund të afatit të likuidimit mund të braktiset nga likuidatori ose t'i jepet një institucioni bamirës që promovon shëndetin ose arsimin publik. Kreditorët e IP-së ose IPE-së nuk kanë asnjë pretendim ndaj pasurive të tilla.
17. Likuidatori i raporton çdo muaj BQK-së për ecurinë e likuidimit në atë formë që mund të përshkruhet nga BQK-ja dhe siguron çdo informacion tjetër me kërkesë të BQK-së.
18. Likuidatori, me miratimin paraprak me shkrim të BQK-së dhe sipas udhëzimeve të saj, ushtron aktivitetet e mëposhtme:
 - 18.1. të disponojë me pasuritë dhe detyrimet e IP-së ose IPE-së përmes një transaksioni të blerjes dhe marrjes përsipër; ose
 - 18.2. të organizojë ristrukturimin e pasurive dhe detyrimeve të IP-së ose IPE-së.

Neni 19

Shmangia e transaksioneve para likuidimit

1. Likuidatori i IP-së ose IPE-së, në kushtet e përshkruara në këtë nen, mund të pezullojë dhe/apo të refuzojë:
 - 1.1. transferimet pa pagesë të bëra nga IP-ja ose IPE-ja te një palë e tretë brenda pesë (5) viteve para emërimit të likuidatorit;
 - 1.2. marrëveshjet e lidhura nga IP-ja ose IPE-ja brenda tri (3) viteve para emërimit të likuidatorit, zbatimi i të cilave ka shkaktuar përkeqësim të gjendjes financiare të IP-së ose IPE-së;
 - 1.3. kontratat pa pagesë dhe aktet e njëanshme që shkaktojnë ose mund t'u shkaktojnë dëm kreditorëve të IP-së ose IPE-së, ose janë të padrejta ose në rrethana të pabarabarta, të lidhura brenda tre (3) viteve para emërimit të likuidatorit;
 - 1.4. çdo kontratë për transferimin e pasurive nga IP-ja ose IPE-ja e lidhur brenda tri (3) viteve para emërimit të likuidatorit, në të cilën vlera e shumës së marrë nga IP-ja ose IPE-ja është dukshëm më e ulët se vlera e tregut të pasurisë së transferuar;
 - 1.5. transaksionet e përfunduara brenda dy (2) viteve para emërimit të likuidatorit ndërmjet IP-së ose IPE-së dhe personave të brendshëm të saj ose personave të lidhur, pagën dhe përfitimet; dhe
 - 1.6. çdo akt apo marrëveshje e lidhur nga IP-ja ose IPE-ja brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve para emërimit të likuidatorit, të cilat përbëjnë preferenca të padrejta ndaj kreditorëve të tjerë, me të cilat një kreditor vendoset në një pozitë më të favorshme se të tjerët në të njëjtin rang prioritetesh.
2. Kërkesat për rikuperimin e parave ose pasurive sipas këtij neni inician brenda një (1) viti pas emërimit të likuidatorit dhe përcaktohen nga Gjykata Kompetente.

Neni 20

Prioritetet në pagesën e pretendimeve

1. Në çdo likuidim të pasurive të një IP-je ose IPE-je, pretendimet e lejuara të siguruara paguhen deri në masën e realizimit të letrës me vlerë ose letra me vlerë i dorëzohet kreditorit të siguruar. Pretendimet e tjera të lejuara paguhen në lidhje me të gjitha borxhet e tjera, sipas rendit të përshkruar më poshtë:
 - 1.1. fondet e përdoruesve të përcaktuara në paragrafin 12 të nenit 18 të kësaj Rregulloreje, ku, në rrethana të jashtëzakonshme, fonde të tilla, që ligjërisht u përkasin përdoruesve, nuk rimbursohen plotësisht nëpërmjet mekanizmave mbrojtës në fuqi. Në këtë rast, shumat e papaguara konvertohen në pretendime të renditura të parat në çdo likuidim të pasurive të një IP-je ose IPE-je në përputhje me këtë Rregullore;
 - 1.2. kreditë e dhëna IP-së ose IPE-së nga BQK-ja deri në emërimin e likuidatorit;
 - 1.3. kreditë e dhëna IP-së ose IPE-së përpara emërimit të likuidatorit dhe nën kolateral, objekt i të cilave janë pasuritë e IP-së ose IPE-së dhe në masën e këtij kolaterali;
 - 1.4. shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të bëra nga likuiduesi dhe BQK-ja, duke përfshirë tarifat profesionale, në zbatim të dispozitave të neneve të likuidimit të kësaj Rregulloreje;
 - 1.5. kreditë e dhëna IP-së ose IPE-së pas emërimit të likuiduesit;
 - 1.6. pretendimet e pasiguruara;
 - 1.7. obligimet e varura, sipas rendit të vartësisë së tyre; dhe
 - 1.8. pretendimet e aksionarëve.
2. Nëse shuma në dispozicion për pagesë për çdo kategori pretendimesh është e pamjaftueshme për të siguruar pagesën e plotë, këto pretendime reduktohen në proporcione të barabarta.

Neni 21

Raportimi përfundimtar në BQK

Pasi të jenë shpërndarë të ardhurat nga shitja e pasurive të një IP-je ose IPE-je, likuidatori i paraqet BQK-së një raport që përfshin një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe burimet dhe përdorimet e fondeve gjatë periudhës së likuidimit. Pas miratimit të raportit nga BQK-ja, likuidimi nga BQK-ja ndërpritet dhe BQK-ja dhe likuidatori lirohen nga çdo përgjegjësi e mëtejshme në lidhje me likuidimin e një IP-je ose IPE-je.

Neni 22

Dispozitat e ndryshme të likuidimit

1. Punonjësve profesionistë të emëruar për të përfaqësuar ose ndihmuar likuidatorin në lidhje me një likuidim nuk u paguhen shuma më të mëdha se sa u paguhen punonjësve ose agentëve të IP-së ose IPE-së për shërbime të ngjashme, përveç se BQK-ja mund të autorizojë pagesa me tarifa më të larta, nëse BQK-ja përcakton se pagesa e tarifave më të larta është e nevojshme për të rekrutuar dhe mbajtur personelin e nevojshëm.

2. BQK-ja ka autoritet të dëmshpërblejë një likuidator dhe agjentët e tij/saj për veprimet e tyre në kushte të tilla që BQK-ja i konsideron të duhura.

Neni 23

Zbatimi, masat korrigjuese dhe ndëshkimet administrative

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje i nënshtrohet masave korrigjuese dhe ndëshkimeve administrative, siç përcaktohet në nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 dhe nenin 125 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës